



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 2800 Prot

VENDIM

14.10.2020

NR. 97, DATË 14.10.2020

PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS TË RADIO TELEVISIONIT SHQIPTAR, PËR
DHËNIEN E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE NË BREZIN FM

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH).

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës të Radio Televizionit Shqiptar, për dhënie e të drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin FM”.

Bazë ligjore: Neni 19, pika 16, neni 54 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016, të AMA-s, i ndryshuar

VËREN SE:

Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH) me shkresat nr. 2570 prot, datë 08.09.2020, dhe nr. 2777 prot, datë 21.09.2020, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), përkatësisht me shkresat nr. 2554 prot, datë 10.09.2020, dhe nr. 2670 prot, datë 23.09.2020, ka kërkuar zgjerimin e rrjetit të transmetimeve audio FM, për “Radio Tirana 1” dhe “Radio Korça”.

Për të realizuar këtë zgjerim, operatori publik ka kërkuar dhënie në përdorim të një frekuence për zonën e shërbimit Bashkia Himarë (për Radio Tirana 1) dhe një frekuence për zonën e shërbimit Bashkia Pogradec (për Radio Korça).

RTSH, bashkëlidhur kërkesave të mësipërme ka paraqitur karakteristikat teknike të pikave së transmetimit Himarë dhe Tushemisht, si koordinatat gjeografike, fuqinë nominale të transmetimit, përforcimin e antenës, fuqinë efektive të rrezatuar E.R.P, azimuthin etj.

Bazuar në të dhënat teknike të paraqitura, Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK (DPFTIK) ka kryer studimin teknik përkatës në programin profesional “HTZ Communications”. Nga ky studim ka rezultuar se, fuqia nominale në pikën e transmetimit Himarë është e lartë duke ndikuar në rritjen e fuqisë efektive të rrezatuar të antenës. Për rrjedhojë, sinjali audio mund të shkaktojë interferenca ndërkuftare me administratat e Greqisë dhe Italisë. Gjithashtu referuar pikës së transmetimit në Tushemisht është ndryshuar këndi i drejtimit të antenës, me qëllim mbulimin me të mirë të zonës së Pogradecit, si dhe shmangien e interferencave ndërkuftare me administratën e Maqedonisë së Veriut.

DPFTIK, bazuar në monitorimin e shfrytëzimit të spektrit audio FM në terren, verifikimeve të kryera në planin e përdorimit të frekuencave audio FM, si dhe analizës inxhinierike të realizuar në programin profesional HTZ Communications me qëllim vlerësimin e mbulimit me sinjal të Bashkisë Himarë dhe Bashkisë Pogradec vlerëson se, RTSH i plotëson kriteret teknike për dhënien në përdorim të një frekuence audio FM, për mbulimin me sinjal të zonës Bashkia Himarë, si dhe të një frekuence audio FM, për mbulimin me sinjal të zonës Bashkia Pogradec.

Neni 54 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikon se *ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, që kërkojnë përdorimin e frekuencave radiotelevizive, licencohet nga AMA, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në përcaktimin e frekuencave që mund të përdoren për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, AMA mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare, me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore dhe duhet të garantojë shmangien e interferencave dhe shfrytëzimin efektiv të spektrit. Caktimi i frekuencave bëhet nga AMA mbi bazën e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, disponueshmërisë së frekuencave të lira dhe, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, vetëm në brezat e frekuencave të përcaktuara për t’u administruar nga AMA.*

Në nenin 18 të rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s i ndryshuar, përcaktohet se: *“Subjekti i licencuar për transmetime kombëtare, rajonale ose lokale audio, për të realizuar përmirësimin e mbulimit nga rrjeti i tyre, kanë të drejtë t’i kërkojnë AMA-s, frekuenca të tjera shtesë brenda zonës së licencimit.”*

Sa më sipër, AMA arrin në përfundimin se kërkesa e RTSH-së është e mbështetur në ligj,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të neni 19, pika 16 dhe nenit 54 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 18 të rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Dhënie e të drejtës së përdorimit të frekuencave 90.5 MHz dhe 91.3 MHz, Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH) mbi mbulimin me sinjal audio të zonës së shërbimit të Bashkisë Himarë (për Radio Tirana 1) dhe Bashkisë Pogradec (për Radio Korça), me karakteristikat teknike, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

Aneksi nr.1

1. Karakteristikat teknike të transmetimit për mbulimin me shërbim të Bashkisë Himarë për “Radio Tirana 1”:

<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat X Y Z</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Amplifikimi (dBd)</i>	<i>ERP (W)</i>	<i>Azimuth (°)</i>	<i>Lartësia e antenës (m)</i>	<i>Drejtimi i antenës</i>
Himarë	90.5	N 40° 05' 15'' E 19° 45' 25''	300	5	949	216	30	D

2. Karakteristikat teknike të transmetimit për mbulimin me shërbim të Bashkisë Pogradec për “Radio Korça”:

<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat X Y Z</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Amplifikimi (dBd)</i>	<i>ERP (kW)</i>	<i>Azimuth (°)</i>	<i>Lartësia e antenës (m)</i>	<i>Drejtimi i antenës</i>
Tushemisht	91.3	N 40° 54' 06'' E 20° 44' 0.11''	500	5	1.58	200	20	D